

URDHËR
Nr. 150, datë 31.3.2022

**PËR ZVOGËLIMIN E NDIKIMIT TË AKTIVITETIT TË PESHKIMIT DHE
RUAJTJEN E SPECIEVE TË RREZIKUARA, SI: BRESHKAT E DETIT, CETACET,
ELASMOBRANKËT DHE SHPENDËT DETARË
[REKOMANDIME TË GFCM/44/2021/13-14-15-16]**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës; të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 3, të “Marrëveshjes për krijimin e Komisionit të Përgjithshëm të Peshkimit për Mesdheun”, të ratifikuar me ligjin nr. 9093, datë 3.7.2003,

URDHËROJ:

1. Zbatimin e rekomandimeve të Komisionit të Përgjithshëm të Peshkimit për Mesdheun, që i bashkëlidhen këtij urdhri dhe që janë pjesë përbërëse e tij:

a) rekomandimi GFCM/44/2021/13, “Për zvogëlimin e ndikimit të peshkimit për ruajtjen e shpendëve detarë në Detin Mesdhe”;

b) rekomandimi GFCM/44/2021/14, “Për zvogëlimin e ndikimit të peshkimit për ruajtjen e breshkave detare”;

c) rekomandimi GFCM/44/2021/15, “Për zvogëlimin e ndikimit të peshkimit për ruajtjen e cetaceve”;

ç) rekomandimi GFCM/44/2021/16, “Për disa masa shtesë lehtësuese për ruajtjen e elasmobrancëve në Detin Mesdhe”.

2. Të gjitha anijet e peshkimit duhet të raportojnë menjëherë Inspektoratin e Peshkimit për zëniet aksidentale të specieve të rrezikuara si: breshkat e detit, cetacet, elasmobrancët, si dhe të shpendëve detarë.

3. Për anijet e peshkimit me gjatësi të barabartë ose mbi 10 metra, raportimi i zënieve aksidentale të kryhet në librin e anijes, duke përcaktuar specien e zënë, si dhe statusin e saj (i zënë, i ngordhur/i gjallë, i lëshuar, i ngordhur/i gjallë).

4. Për anijet e peshkimit me gjatësi nën 10 metra, raportimi i zënieve aksidentale me anë të vetëdeklarimit, duke përcaktuar specien e zënë, si dhe statusin e saj (i zënë, i ngordhur/i gjallë, i lëshuar, i ngordhur/i gjallë).

5. Përveç raportimit të përcaktuar në pikat 3 dhe 4 të këtij urdhri, kur është e mundur, anijet e peshkimit dërgojnë pamje fotografike dhe/ose filmike të këtyre specieve, si edhe gjatë lëshimit të tyre.

6. Lëshimi i këtyre specieve në det të kryhet sa më shpejt, pa i dëmtuar ato dhe të gjalla, brenda mundësive.

7. Aktiviteti i peshkimit artizanal lejohet një orë pas përfundimit deri në një orë para agimit.

8. Aktiviteti i peshkimit me përdorim të linjave të grepave/parangallëve lejohet nga agimi në përfundim.

9. Ndalohet shkarkimi i hedhurinave gjatë lëshimit dhe tërheqjes së mjeteve të peshkimit.

10. Rrjetat dhe pajisjet e tjera të peshkimit duhet të pastrohen përpara lëshimit të tyre.

11. Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës ushtron kontrollin e aktivitetit, me qëllim zvogëlimin e ndikimit të peshkimit. Sektori i Monitorimit, Përpunimit dhe Analizës së të Dhënave, në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës, grumbullon të dhënat mbi zëniet rastësore të specieve të rrezikuara, të përmendura në këtë urdhër.

12. Drejtoria e Politikave dhe Programeve të Peshkimit dhe Akuakulturës harton masa të mëtejshme për zvogëlimin e ndikimit të aktivitetit të peshkimit dhe ruajtjen e specieve të rrezikuara të përmendura në këtë urdhër.

13. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Drejtoria e Politikave dhe Programeve të Peshkimit dhe Akuakulturës, dhe Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca

REKOMANDIMI GFCM/44/2021/13

PËR ZVOGËLIMIN E NDIKIMIT TË AKTIVITETIT TË PESHKIMIT NË RUAJTJEN E SHPENDËVE DETARË NË DETIN MESDHE

Komisioni i Përgjithshëm i Peshkimit për Mesdheun (GFCM),

duke rikujtuar Agjendën e 2030-s për Zhvillim të Qëndrueshëm të miratuar në kontekstin e Samitit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin e Qëndrueshëm (Nju Jork, shtator 2015) dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara (SDGs), në veçanti SDG 14 “Ruajtja dhe përdorimi i qëndrueshëm i burimeve të oqeanëve, deteve dhe ujore” dhe objektivi 14.2 që kërkon në mënyrë specifike “menaxhimin e qëndrueshëm dhe mbrojtjen e ekosistemeve detare dhe bregdetare për të shmangur ndikime negative të padëshirueshme [...] dhe për të ndërmarrë veprime për restaurimin e tyre, me qëllim arritjen në nivele të shëndetshme dhe produktive të oqeanëve”;

duke rikujtuar më tej se objektivi i Marrëveshjes për krijimin e Komisionit të Përgjithshëm të Peshkimit për Mesdheun (Marrëveshja GFCM) është të sigurojë ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm, në nivel biologjik, social, ekonomik dhe mjedisor, të të gjitha burimeve të gjalla detare në zonën e zbatimit të GFCM-së;

duke ripobuar parimet e Kodit të Sjelljes për Peshkimin e Përgjegjshëm të FAO-s dhe duke kujtuar qasjen e kujdesshme ndaj ekosistemit për menaxhimin e peshkimit;

duke marrë parasysh Planin Ndërkombëtar të Veprimit të FAO-s për Reduktimin e Zënieve Rastësore të Shpendëve Detarë nga aktiviteti i peshkimit me linja grepash (IPOA-seabirds);

duke njohur se Deti Mesdhe dhe Deti i Zi janë pikat kryesore globale të biodiversitetit dhe habitate kritike për shpendët e detit;

duke konsideruar se të gjitha masat e formuluar nga GFCM-ja do të bazohen në këshillat më të mira shkencore të disponueshme, duke marrë parasysh faktorët përkatës mjedisorë, ekonomik dhe social;

duke rikujtuar rekomandimet nga Rishikimi i Dytë i Performancës së GFCM-së që kërkojnë zhvillimin e masave të ruajtjes dhe planit të menaxhimit, duke përdorur plotësisht ndërlidhjen shkencë-politikë të ofruar nga Komiteti Këshillimor Shkencor (SAC); GFCM-ja duhet të ndërmarrë masat e duhura të menaxhimit të përkohshëm (brenda 5 viteve) për të ruajtur aktivitetin e peshkimit, resurset dhe habitatet e prekura nga aktiviteti i peshkimit tregtar artizanal;

duke vënë re se nënshkruesit e Deklaratës Ministeriale të Maltës MedFish4Ever 2017, konkretisht paragrafi 37, që u kërkoj të gjitha shteteve bregdetare të respektojnë masat e menaxhimit të miratuara nga GFCM-ja dhe të sigurojnë mbrojtjen e duhur të specieve të rrezikuara, duke përfshirë shpendët e detit;

duke vënë re më tej se Deklarata Ministeriale e Sofjes 2018, mbi peshkimin dhe akuakulturën e Detit të Zi, veçanërisht paragrafët 27 dhe 47, u bën thirrje vendeve bregdetare të Detit të Zi të rrisin

bashkëpunimin shumëpalësh dhe të ndërmarrin masa për të përmirësuar qëndrueshmërinë e burimeve, veçanërisht në lidhje me grumbullimin e të dhënave, vlerësimin shkencor dhe zbatimin e një kuadri të menaxhimit të peshkimit të bazuar në ekosistem në Detin e Zi;

duke rikujtuar miratimin e një strategjie të re të GFCM-së (2021–2030), drejt peshkimit të qëndrueshëm për Mesdheun dhe Detin e Zi, që përfshin një objektiv specifik për minimizimin dhe zbutjen e ndërveprimeve të padëshiruara midis peshkimit, ekosistemeve detare dhe mjedisit;

duke konsideruar se disa lloje shpendësh detarë janë të listuar në shtojcën II për speciet e rrezikuara dhe të kërcënuara të protokollit, në lidhje me Zonat Posaçërisht të Mbrojtura me Diversitetin Biologjik në Mesdhe (protokolli SPA/BD) të Konventës për Mbrojtjen e Mjedisit Detar dhe Rajonit Bregdetar të Mesdheut (Konventa e Barcelonës), dhe se Qendra e Veprimtarisë Rajonale për Zonat e Veçanta të Mbrojtura (RAC/SPA) ka zbatuar një plan veprimi rajonal;

duke konsideruar më tej se Lista e Kuqe e Llojeve të Kërcënuara të IUCN-së njih statusin “ruajtje e tjetërsuar” për të gjithë shpendët detarë në Detin Mesdhe dhe në Detin e Zi, si p.sh.: lajmëtari i furtunës (*Puffinus mauretanicus*), lajmëtari i vogël i furtunës (*Puffinus yelkouan*), pulëbardha sqepkuqe (*Larus audouinii*).

duke konsideruar nevojën për të zhvilluar një strategji të përbashkët rajonale për të kuptuar dhe reduktuar ndjeshëm efektin e peshkimit mbi shpendët detarë, duke përfshirë edhe bazën e informacionit të mbledhur nëpërmjet protokolleve të unifikuara;

duke njohur se shumica e vdekshmërisë nga zëniet rastësore dhe peshkimit për shpendët detarë në Detin Mesdhe dhe Detin e Zi shkaktohen nga peshkimi fundor dhe me linja grepash, dhe se duhet të miratohen masa për të minimizuar dhe zvogëluar ndërveprime të tilla të padëshiruara;

duke kujtuar ndikimin e mundshëm të peshkimit të paligjshëm, të paraportuar dhe të parregulluar (IUU) për shumë lloje shpendësh detarë;

të shqetësuar se, pavarësisht masave të miratuara në nivel ndërkombëtar, duke përfshirë përmes rekomandimit GFCM/35/2011/3, për shumë popullata të shpendëve detarë, duke përfshirë lajmëtarin e furtunës (*Puffinus mauretanicus*), shumimi dhe të ushqyerit në zonën e zbatimit të GFCM-së vazhdojnë të bien dhe se reduktime të tilla kërcënojnë shumë seriozisht mbijetesën e këtyre specieve;

duke konsideruar se sinergjitë për çështjet me interes reciprok do të kërkojnë ndërmjet Organizatave Rajonale të Menaxhimit të Peshkimit, duke përfshirë rekomandimin 07-07 të ICCAT-it për reduktimin e zënieve rastësore të shpendëve detarë në peshkimin me linjë grepash dhe rekomandimet e CCAMLR-së 24-02, 25-02 dhe 25-03, për reduktimin e zënieve të rastësishme të shpendëve detarë në peshkimin fundor dhe me linja grepash;

duke marrë parasysh këshillën e Komitetit Këshillimor Shkencor për Peshkimin (SAC) për zëniet e rastësishme të shpendëve detarë dhe veçanërisht këshillën e Grupit të Punës për Teknologjinë e Peshkimit në 2021-shin nga SAC-i mbi nevojën për të rritur selektivitetin e veglave të peshkimit për të reduktuar zëniet e rastësishme dhe për të siguruar një status më të mirë të ruajtjes së shpendëve të detit;

miraton, në përputhje me nenet 5/b, 8/b dhe 13, të Marrëveshjes GFCM, rekomandimin e mëposhtëm:

PJESA I OBJEKTIVAT DHE QËLLIMI I PËRGJITHSHËM

Objektivat e përgjithshëm

1. Ky rekomandim angazhon CPC-të për të zhvilluar mekanizma që sigurojnë mbledhjen e të dhënave shtesë mbi zëniet e rastësishme të shpendëve detarë në aktivitetet e peshkimit.

2. Ky rekomandim përcakton gjithashtu masa për të përmirësuar statusin e ruajtjes së shpendëve detarë dhe për të zvogëluar, lehtësuar dhe, kur është e mundur, eliminuar ndërveprimet e padëshiruara midis aktiviteteve të peshkimit dhe shpendëve detarë, veçanërisht për speciet e listuara nën shtojcën II, të protokollit SPA/BD të Konventës së Barcelonës.

3. Ky rekomandim angazhon CPC-të të zhvillojnë masa për ruajtjen në zonat me rrezik të lartë të përcaktuara nga SAC-i, duke siguruar që zëniet e rastësishme gjatë aktivitetit të peshkimit për lajmëtarin e furtunës (*Puffinus mauretanicus*) të monitorohen dhe eliminohen aty ku është e mundur dhe duke marrë parasysh masat kombëtare.

Qëllimi

4. Ky rekomandim do të zbatohet për të gjitha aktivitetet e peshkimit tregtar në GSA-të 1 deri në 27, ku ndodhin zëniet rastësore të shpendëve detarë të listuar në shtojcën II, të protokollit SPA/BD të Konventës së Barcelonës, kryesisht kur zihen rastësisht gjatë aktiviteteve të peshkimit në përputhje me këshillat e SAC-it.

PJESA II OBJEKTIVAT SPECIFIKË

5. Ky rekomandim do të kontribuojë në objektivat e përmendur në nenin 2 dhe parimet e renditura në nenin 5 të Marrëveshjes GFCM.

6. Në veçanti, rekomandimi do të synojë:

a) të përmirësojë njohuritë shkencore, teknike dhe socio-ekonomike të peshkimit për zëniet rastësore të shpendëve detarë, duke zbatuar masat e parashikuara në rekomandimin GFCM/35/2011/3 dhe në Kornizën Referuese për Grumbullimin e të Dhënave GFCM (DCRF);

b) të vlerësojë dhe të zhvillojë masa lehtësuese për zonat me zënie rastësore të lartë për lajmëtarin e furtunës, për të siguruar që këto zënie të regjistrohen dhe monitorohen, dhe të hartohen zgjidhje për t'i mbajtur zëniet në nivelin më të ulët të mundshëm;

c) të hartojë, nëse është e nevojshme dhe mbështetur në këshillat e SAC-it, një protokoll për grumbullimin e të dhënave dhe raportimin e zënieve rastësore të shpendëve të detit gjatë aktiviteteve të peshkimit;

ç) të zhvillojë masa zbutëse kalimtare për zonat me zënie të larta të rastësishme për të siguruar që këto zënie rastësore të regjistrohen, monitorohen dhe të hartohen zgjidhje për t'i mbajtur ato në nivelin më të ulët të mundshëm;

d) të zhvillojë projekte pilot për speciet e shpendëve detarë me status “ruajtje e tjetërsuar” në Detin Mesdhe dhe Detin e Zi, të tilla si lajmëtari i furtunës (*Puffinus mauretanicus*) i rrezikuar në mënyrë kritike, lajmëtari i vogël i furtunës (*Puffinus yelkouan*), pulëbardha sqepkuqe (*Larus audouinii*) dhe lajmëtari madh i furtunës (*Calonectris diomedea*).

PJESA III MONITORIMI DHE GRUMBULLIMI I TË DHËNAVE

7. Në përputhje me rekomandimin GFCM/35/2011/3, CPC-të do të raportojnë sistematikisht informacionin mbi normat e kapjes rastësore të shpendëve të detit në përputhje me detyrën 3 (task 3) të manualit teknik DCRF (shih shtojcën 1 të këtij rekomandimi).

8. Duke filluar nga viti 2022 e në vazhdim, të gjitha CPC-të do të përfshihen në grumbullimin e të dhënave për të karakterizuar plotësisht zëniet e rastësishme të shpendëve detarë nga aktiviteti i peshkimit, duke përfshirë edhe lajmëtarin e furtunës, si specie e rrezikuar në mënyrë kritike. Prandaj, përveç detyrimeve të raportimit që rrjedhin nga DCRF-ja, CPC-të do të raportojnë çdo vit, deri më

30 prill, mbi elementet e listuara në shtojcën 2 që mund të plotësohen bazuar në rekomandimin e SAC-it.

9. Me kërkesë të CPC-ve, me asistencën e Sekretariatit të GFCM, GFCM do të krijojë, në vitin 2023, projekte pilot me synimin për të forcuar programet ekzistuese të vëzhgimit dhe monitorimit për të mbledhur të dhëna shtesë dhe për të siguruar përputhjen me masat e ruajtjes dhe menaxhimit të përfshira në këtë rekomandim.

10. SAC i kërkohet të përpilojë dhe vlerësojë në vitin 2025 të gjithë informacionin e disponueshëm të raportuar sipas rekomandimit GFCM/35/2011/3 mbi zëniet e rastësishme të shpendëve detarë nga aktiviteti i peshkimit në zonën e zbatimit të GFCM-së sipas DCRF-së dhe çdo burimi tjetër informacioni shtesë duke përfshirë, por pa u kufizuar, në literaturën shkencore, fushatat kërkimore në det, projektet kërkimore etj. Bazuar në të dhënat e mbledhura, SAC-i do të përshtatë dhe plotësojë, nëse është e nevojshme, mbi bazën e aktivitetit të peshkimit, masat e renditura në shtojcën 3 të këtij rekomandimi për të zvogëluar, lehtësuar dhe ku është e mundur, eliminuar zëniet e rastësishme, si dhe për të reduktuar vdekshmërinë pas lëshimit me udhëzime¹ dhe trajnime të përshtatshme.

11. Në vitin 2022, seminari aktual i GFCM-së mbi speciet detare të cenueshme dhe të ndjeshme do të identifikojë zonat me rrezik të lartë për zëniet rastësore. Një punë pasuese mbi të dhënat shtesë të mbledhura nga projektet pilote do të kryhet në vitin 2025, për të përfunduar hartimin paraprak dhe përshtatur masat kalimtare të ruajtjes. Të gjitha rezultatet duhet të paraqiten në SAC, në 2025, në mënyrë që SAC-i të japë një këshillë për masat e ruajtjes.

PJESA IV MASAT E RUAJTJES

12. Përveç rekomandimit ekzistues të GFCM 35/2011/3, CPC-të do të vlerësojnë efektivitetin e të paktën dy masave lehtësuese kalimtare nga shtojca 3, deri në vitin 2024, për të përmirësuar statusin e ruajtjes për speciet e shpendëve detarë, për të lehtësuar dhe ku është e mundur për të eliminuar rrezikun për kapjet rastësore të shpendëve detarë në aktivitetet e peshkimit dhe vdekshmërisë shoqëruese. Në zonat me zënie të mëdha të rastësishme të lajmëtarit të furtunës (*puffinus mauretanicus*) të identifikuar në 2022 nga grupi i punës/trajnimet e GFCM-së, me kusht që të mos ketë masa kombëtare të vendosura, dy nga masat lehtësuese në shtojcën 3 do të vlerësohen të paktën deri në fund të 2023-shit, në mënyrë që të zvogëlohet vdekshmëria e rastësishme e kësaj specie gjatë peshkimit me linjë grepash dhe trata, duke minimizuar tërheqjen e tyre nga anijet e peshkimit dhe duke i parandaluar ato nga tentativa e kapjes të grepat e karremit, veçanërisht gjatë periudhës kur vendosen linjat ose duke hyrë në kabllot e tratave.

PJESA V DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

13. Bazuar në të gjitha të dhënat e grumbulluara dhe të disponueshme në literaturë, SAC-i në vitin 2022, do të:

- a) hartojë zonat me rrezik të lartë për zëniet rastësore për çdo specie të shpendëve detarë të mbuluar nga ky rekomandim;
- b) përshtatë dhe plotësojë, nëse është e nevojshme, listën e masave të mundshme lehtësuese për këto zona; dhe

¹ Shih: Accobams/GFCM/FAO Good practice guide for the handling of seabirds caught incidentally in fisheries <http://www.fao.org/gfcm/publications/projectsandinitiatives/en/>.

c) vlerësojë skenarët për mënyrat e peshkimit, veglat e peshkimit dhe variabla të tjera ku ka më shumë gjasë të ndodhin zëniet e rastësishme, për shembull në zonat e mbrojtura, zona ku ushqehen gjatë sezoneve të shumimit/folezimit dhe zhvillojnë rekomandime për veprime që do të përmirësonin parandalimin e zënieve të rastësishme të shpendëve detarë. Kjo duhet të bëhet nga SAC-i duke marrë parasysh ndikimet socio-ekonomike, si dhe mjedisore për skenarë të tillë.

14. Sesioni i njëzet e gjashtë i SAC në vitin 2025 do të raportojë mbi progresin e arritur, boshllëqet e identifikuara në njohuri dhe do të sigurojë elementet e nevojshme për vendosjen e masave të ardhshme për të përmirësuar ruajtjen e shpendëve detarë në zonën e zbatimit të GFCM-së. SAC-i dhe Komiteti i Pajtushmërisë (CoC) do të shqyrtojnë zbatimin e këtij rekomandimi në bazë dyvjeçare.

15. Në sesionin e saj të 48-të, në 2025-n GFCM-ja do të shqyrtojë këshillat e SAC-it dhe do të marrë në konsideratë miratimin e masave zbutëse afatgjata për arritjen e objektivave të këtij rekomandimi.

16. Dispozitat e këtij rekomandimi nuk paragjykojnë masat shtesë ose më të rrepta të miratuara ose që mund të miratohen nga CPC-të.

SHTOJCA 1

Detyra 3 e manualit teknik të DCRF-së kërkon që çdo CPC të raportojë çdo vit elementet e mëposhtme:

- vitin;
- segmentin e flotës;
- veglat e peshkimit;
- grupin e specieve vulnerabël;
- familjen;
- speciet (kur është e mundur);
- numrin total të individëve të zënë;
- peshën totale të individëve të vdekur të zënë;
- numrin e individëve të liruar të gjallë;
- numrin e individëve të vdekur;
- numrin e individëve të liruar në gjendje të panjohur.

SHTOJCA 2

Përveç elementeve të listuara në shtojcën 1, CPC-të do të raportojnë çdo vit; nëse është e mundur, deri më 30 prill, si vijon:

- raportimin e anijes së peshkimit IMO, datën, kohën dhe vendin e zënies, madhësinë e individëve të zënë të vdekur dhe vlerësimet e madhësisë së individëve të zënë të gjallë;
- llogaritjen e shkallës së vdekshmërisë nga zëniet rastësore të shpendëve detarë, lidhur me çdo formë peshkimi, detajet mbi speciet e shpendëve detarë të ndikuara dhe vlerësimet totale të vdekshmërisë së shpendëve detarë (në nivel GSA-je ose nivel drejtkëndëshi statistikor të GFCM-së, nëse është e mundur);
- masat për të reduktuar ose eliminuar vdekshmërinë nga zëniet e rastësishme të shpendëve detarë që përdoren për secilën formë peshkimi, si dhe përcaktimin nëse ndonjë prej tyre është vullnetare ose e detyrueshme, së bashku me një vlerësim të efektivitetit të tyre;

- programe vëzhgimi shkencorë që mund të ofrojnë mbulim shtesë hapësinor dhe kohor në aktivitetin e peshkimit, për të lejuar një vlerësim statistikor të fortë mbi zëniet e rastësishme të shpendëve detarë të ndërlidhur me aktivitetin e peshkimit.

SHTOJCA 3

Masat lehtësuese mund të përfshijnë, ndër të tjera, elementet e mëposhtme që duhet të përshtaten në përputhje me çdo formë peshkimi:

a) vendosja preferenciale e pajisjeve të peshkimit gjatë natës (një orë pas muzgut dhe një orë para agimit);

b) përdorimi i veglave të modifikuar me peshë të shtuar. Anijet duhet të inkurajohen të zhvillojnë konfigurime të veglave të peshkimit që do të minimizojnë mundësinë që shpendët detarë të ndeshen me pjesët e rrjetës, litarët, grepat ndaj të cilave ata janë më të prekshëm. Kjo mund të përfshijë rritjen e peshës ose zvogëlimin e lëvizshmërisë së pajisjes së peshkimit në mënyrë që të zhyten më shpejt;

c) përdorimi i një vegle të modifikuar me të paktën një *linjë tori* me shirita me ngjyra: Shiritat me ngjyra të ndezura mund të jenë të shkurtër ose të gjatë, ose të dyja. Rekomandohet që shiritat e shkurtra të vendosen në intervale 1 m përgjatë shtrirjes ajrore të linjës, dhe shiritat e gjata në intervale 5 m përgjatë gjithë shtrirjes ajrore të linjës. Për anijet e peshkimit nën 35 m gjatësi, *linja tori* duhet të ketë një lartësi prej të paktën 6 m, një shtrirje ajrore prej 75 m dhe shirita që prekin sipërfaqen e ujit çdo 5 m gjatë 55 m të para të linjës. Duhet të përdoret një pajisje e përshtatshme për të siguruar tërheqjen, për të maksimizuar shtrirjen ajrore dhe për të siguruar që linja të qëndrojë direkt pas anijes edhe në situatat kur era është në drejtimin e kundërt;

ç) të ndalohet shkarkimi i mbetjeve gjatë lëshimit dhe tërheqjes së veglave të peshkimit. Rrjetat dhe pajisjet e tjera të peshkimit duhet të pastrohen përpara lëshimit për të hequr sendet që mund të tërheqin zogjtë. Për më tepër, anijet duhet të miratojnë procedura lëshimi dhe tërheqje për të zvogëluar kohën që veglat e peshkimit qëndrojnë në sipërfaqen e ujit. Mirëmbajtja e rrjetës dhe veglave të tjera, për aq sa është e mundur, nuk duhet të kryhet kur vegla është në ujë;

d) përmirësim i vazhdueshëm i kapaciteteve (d.m.th. trajnimi) për të praktikuar “lëshimin e sigurt”;

dh) aktivitetet e peshkimit duhet të kryhen në mënyrë të tillë që linjat e grepave ose kavot të fundosen sa më shpejt që të jetë e mundur pasi të futen në ujë;

e) të vendoset një litar me shirita gjatë lëshimit të veglave të peshkimit për të penguar që zogjtë t'i afrohen kabllove ose rrjetave të peshkimit;

ë) të përdoren gjatë tërheqjes së linjave të grepave pajisje për përjashtimin e zogjeve, të krijuara për të larguar shpendët detarë nga karremi, gjatë tërheqjes së linjave më të gjata;

f) të ndërmerret çdo përpjekje për të siguruar që shpendët e zënë të gjallë gjatë peshkimit të lirohen dhe që, nëse është e nevojshme, të hiqen grepat pa rrezikuar jetën e tyre.

REKOMANDIMI GFCM/44/2021/14

PËR ZVOGËLIMIN E NDIKIMIT TË AKTIVITETIT TË PESHKIMIT NË RUAJTJEN E BRESHKAVE DETARE

Komisioni i Përgjithshëm i Peshkimit për Mesdheun (GFCM),

duke rikujtuar se objektivi i Marrëveshjes për krijimin e Komisionit të Përgjithshëm të Peshkimit për Mesdheun (Marrëveshja GFCM) është të sigurojë ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm, në

nivel biologjik, social, ekonomik dhe mjedisor, të të gjitha burimeve të gjalla detare në zonën e zbatimit të GFCM-së;

duke konsideruar se zëniet e rastësishme të breshkave detare nga aktiviteti i peshkimit mund të ndikojnë seriozisht në popullatat e breshkave të detit në zonën e zbatimit të GFCM-së;

duke rikujtuar rekomandimet nga Rishikimi i Dytë i Performancës së GFCM-së që kërkojnë zhvillimin e masave të ruajtjes dhe planit të menaxhimit, duke përdorur plotësisht ndërlidhjen shkencë-politikë të ofruar nga Komiteti Këshillimor Shkencor (SAC); GFCM-ja duhet të ndërmarrë masat e duhura të menaxhimit të përkohshëm (brenda 5 viteve) për të ruajtur aktivitetin e peshkimit, resurset dhe habitatet e prekura nga aktiviteti i peshkimit tregtar artizanal;

duke rikujtuar protokollin në lidhje me Zonat e Mbrojtura të Posaçme dhe Diversitetin Biologjik në Mesdhe (protokolli SPA/BD) të Konventës për Mbrojtjen e Mjedisit Detar dhe Rajonit Bregdetar të Mesdheut (Konventa e Barcelonës) dhe listimin e disa llojeve të zvarranikëve detarë që ndodhen në zonën e zbatimit të kësaj konvente;

duke rikujtuar rekomandimin GFCM/29/2005/3 që ndalon përdorimin e rrjetave të fiksuara (lundruese) për peshkimin e pelagjikëve të mëdhenj;

duke rikujtuar miratimin e një strategjie të re të GFCM-së (2021–2030) drejt peshkimit të qëndrueshëm për Mesdheun dhe Detin e Zi ku përfshihet objektivi 4 “Për të zvogëluar dhe zbutur ndërveprimet e padëshiruara midis peshkimit dhe ekosistemeve, dhe mjediseve detare”, në veçanti zhvillimin e veprimeve që lidhen me outputin 4.2 “Ekosisteme detare më të shëndetshme dhe peshkim më produktiv”;

duke rikujtuar se Deklarata Ministeriale e Maltës MedFish4Ever e vitit 2017 (në tekstin e më poshtëm “Deklarata MedFish4Ever”) kërkon, në kuadrin e hartimit të një plani menaxhimi për peshkimin të bazuar në ekosistem, duke siguruar mbrojtjen e duhur të specieve të rrezikuara dhe habitateve të ndjeshme;

duke synuar reduktimin e zënieve të rastësishme të breshkave të detit në zonën e zbatimit të GFCM-së, duke ndihmuar kështu në përmirësimin e statusit të ruajtjes së këtyre kafshëve, në përputhje me një qasje pro ekosistemit për menaxhimin e peshkimit;

duke njohtë, gjithashtu, nevojën për të mbledhur më shumë të dhëna dhe informacion teknik për të vlerësuar plotësisht avantazhet dhe rreziqet që lidhen me miratimin e mundshëm të masave të tjera si ndryshimi i karakteristikave të mjeteve të peshkimit, si dhe çdo ndikim tjetër të mundshëm në aktivitetet e peshkimit;

duke rikujtuar rekomandimin GFCM/35/2011/4 mbi zëniet e rastësishme të breshkave të detit nga aktiviteti i peshkimit në zonën e zbatimit të GFCM-së;

duke marrë parasysh këshillën e Grupit të Punës për Teknologjinë e Peshkimit 2021, nga SAC-i dhe, në veçanti, nevojën për të rritur selektivitetin e veglave të peshkimit për të zvogëluar zëniet e rastësishme dhe për të siguruar një status më të mirë ruajtjeje të breshkave të detit;

miraton, në përputhje me nenet 5/b, 8/b dhe 13, të Marrëveshjes GFCM, rekomandimin e mëposhtëm:

PJESA I QËLLIMET

1. Palët kontraktuese dhe palët jokontraktuese bashkëpunuese (CPC) duhet të nxisin veprimtari të mëtejshme për të përmirësuar statusin e ruajtjes së breshkave detare dhe masat për të ulur ose eliminuar rrezikun e zënieve rastësore të breshkave të detit gjatë aktivitetit të peshkimit ose vdekshmërinë e lidhur me këto zënie të rastësishme.

2. CPC-të duhet të përmirësojnë informacionin e raportuar mbi normat e zënieve rastësore të breshkave të detit, në përputhje me manualin teknik të Kornizës Referuese për Mbledhjen e të Dhënave të GFCM-së (DCRF).

3. CPC-të inkurajohen të ndërmarrin hapat e nevojshëm për të zbatuar legjislacionin ekzistues dhe masat për të zvogëluar ose kur është e mundur për të eliminuar zëniet e rastësishme të breshkave të detit gjatë aktivitetit të peshkimit, por pa u kufizuar në:

- llojet alternative të veglave të peshkimit dhe modifikimin e tyre;
- kufizime dhe mbyllje të aktivitetit të peshkimit në periudha kohore bazuar për shembull në masa për njohjen hapësinore në identifikimin e pranisë së breshkave të detit;

- përmirësime në veglat e peshkimit për shënjimimin dhe zbulimin (duke përfshirë reflektimin zanor, përdorimin e rrjetave me ngjyra, reflektorët pasivë të lehtë, diametrin më të trashë të spangos, përdorimin e tapave ose materialeve të tjera brenda rrjetës, përbërjet metalike që kanë veçori të zbulimit akustik si sulfati i bariumit, rrjetat e ndriçuara me shkopinjtë dritash që funksionojnë me bateri);

- zbatimi i pragjeve maksimale të mundshme për zëniet e rastësishme dhe pajisje për përjashtimin e breshkave me pajisje klasifikimi dhe shoqëruese;

- ndryshime në mënyrat dhe strategjinë e peshkimit (p.sh.: zvogëlimi i kohës së zhytjes për veglat e peshkimit, grumbullimi i rrjetave gjatë ditës, vendosja e grepave në thellësi më të mëdha se thellësitë ku ndeshen më shpesh breshkat (40–100 m)).

4. CPC-të inkurajohen të lehtësojnë zbatimin e masave për të shmangur dëmtimin gjatë procesit të lirit dhe për të reduktuar vdekshmërinë pas lirit me udhëzime¹ dhe trajnime të përshtatshme.

5. Në vitin 2026, CPC-të duhet të njoftojnë të paktën dy masa lehtësuese të miratuara sipas neneve 3 dhe 4, për të përmirësuar statusin e ruajtjes së breshkave të detit, për të zvogëluar ose nëse është e mundur për të eliminuar rrezikun për zëniet e rastësishme të breshkave të detit gjatë aktivitetit të peshkimit dhe vdekshmërinë e tyre. Në këtë drejtim, duhet të merren parasysh zonat dhe segmentet e flotës me rreziqe më të larta ndërveprimi.

PJESA II MONITORIMI, PËRSHTATJA DHE ANALIZIMI SHKENCOR

6. SAC-it i kërkohet të plotësojë dhe vlerësojë të gjitha të dhënat e disponueshme, informacionet dhe veprimet e raportuara sipas rekomandimit GFCM/35/2011/4, “*mbi zëniet e rastësishme të breshkave të detit nga aktiviteti i peshkimit në zonën e zbatimit të GFCM-së*” sipas DCRF-së dhe çdo burimi tjetër informacioni shtesë, duke përfshirë, por pa u kufizuar, literaturën shkencore, sondazhet në det, projektet kërkimore etj.

7. Me kërkesë të CPC-ve, me ndihmën e sekretariatit të GFCM-së, GFCM-ja do të krijojë, jo me vonë se 2023-shi, projekte pilot me synim forcimin e programeve ekzistuese të vëzhgimit dhe monitorimit në mënyrë që të grumbullohen të dhëna shtesë dhe të sigurohet përputhshmëria me masat e menaxhimit dhe ruajtjes, të përfshira në këtë rekomandim.

8. Sesioni i 26-të i SAC-it në 2025-n duhet të raportojë në GFCM mbi progresin e arritur, identifikimin e boshllëqeve në njohuri dhe të sigurojë elementet e nevojshme për vendosjen e masave të ardhshme me qëllim ruajtjen e popullatave të breshkave të detit në zonën e zbatimit të GFCM-së.

¹ Shih: Accobams/GFCM/FAO Good practice guide for the handling of sea turtles caught incidentally in fisheries <http://www.fao.org/gfcm/publications/projectsandinitiatives/en/>.

9. Në sesionin e tij të 48-të në 2025-n, pas marrjes së këshillës nga SAC-i, GFCM-ja mund të shqyrtojë, nëse është e përshtatshme, miratimin e masave të mëtejshme që lejojnë arritjen e qëllimeve të këtij rekomandimi.

10. Dispozitat e këtij rekomandimi nuk paragjykojnë masat shtesë ose më shtrënguese të miratuara ose që mund të miratohen nga CPC-të.

REKOMANDIMI GFCM/44/2021/15

PËR RUAJTJEN DHE ZVOGËLIMIN E NDIKIMIT TË AKTIVITETIT TË PESHKIMIT PËR RUAJTJEN E CETACEVE

Komisioni i Përgjithshëm i Peshkimit për Mesdheun (GFCM),

duke rikujtuar se objektivi i Marrëveshjes për krijimin e Komisionit të Përgjithshëm të Peshkimit për Mesdheun (Marrëveshja GFCM) është të sigurojë ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm, në nivel biologjik, social, ekonomik dhe mjedisor, të të gjitha burimeve të gjalla detare në zonën e zbatimit të GFCM-së;

duke konsideruar se zëniet e rastësishme të cetaceve nga aktiviteti i peshkimit mund të ndikojnë seriozisht këto popullatat në zonën e zbatimit të GFCM-së;

duke rikujtuar rekomandimet nga Rishikimi i Dytë i Performancës së GFCM-së, që kërkojnë zhvillimin e masave të ruajtjes dhe planit të menaxhimit, duke përdorur plotësisht ndërlidhjen shkencë-politikë të ofruar nga Komiteti Këshillimor Shkencor (SAC); GFCM-ja duhet të ndërmarrë masa e duhura të menaxhimit të përkohshëm (brenda 5 viteve) për të ruajtur peshkimin, rezervat dhe habitatet e prekura nga peshkimi, duke përfshirë peshkimin artizanal;

duke rikujtuar Marrëveshjen për Ruajtjen e Cetaceve në Detin e Zi, Detin Mesdhe dhe Zonës së Atlantikut (ACCOBAMS), objektivat e së cilës përfshijnë reduktimin e ndikimeve negative të aktivitetit të peshkimit ndaj cetaceve;

duke rikujtuar protokollin në lidhje me Zonat e Mbrojtura të Posaçme dhe Diversitetin Biologjik në Mesdhe (protokolli SPA/BD) të Konventës për Mbrojtjen e Mjedisit Detar dhe Rajonit Bregdetar të Mesdheut (Konventa e Barcelonës) dhe listimin e disa llojeve të zvarranikëve detarë që ndodhen në zonën e zbatimit të kësaj konvente;

duke rikujtuar rekomandimin GFCM/29/2005/3, që ndalon përdorimin e rrjetave të fiksuara (lundruese) për peshkimin e pelagjikëve të mëdhenj;

duke rikujtuar miratimin e një strategjie të re të GFCM-së (2021–2030) drejt peshkimit të qëndrueshëm për Mesdheun dhe Detin e Zi ku përfshihet objektivi 4 “Për të zvogëluar dhe zbutur ndërveprimet e padëshiruara midis peshkimit dhe ekosistemeve, dhe mjediseve detare”, në veçanti zhvillimin e veprimeve që lidhen me outputin 4.2 “Ekosisteme detare më të shëndetshme dhe peshkim më produktiv”;

duke rikujtuar se Deklarata Ministrale e Maltës MedFish4Ever, e vitit 2017 (në tekstin e më poshtëm “Deklarata MedFish4Ever”) kërkon, në kuadrin e hartimit të një plani menaxhimi për peshkimin të bazuar në ekosistem, duke siguruar mbrojtjen e duhur të specieve të rrezikuara dhe habitateve të ndjeshme;

duke synuar reduktimin e zënieve të rastësishme të cetaceve në zonën e zbatimit të GFCM-së, duke ndihmuar kështu në përmirësimin e statusit të ruajtjes së këtyre kafshëve, në përputhje me një qasje pro ekosistemit për menaxhimin e peshkimit;

duke marrë parasysh këshillën e SAC-it për Peshkimin, mbi nevojën e miratimit të masave për të zvogëluar zëniet rastësore të cetaceve;

duke njohur nevojën për të grumbulluar më shumë të dhëna dhe informacion teknik për të vlerësuar plotësisht avantazhet dhe rreziqet që lidhen me miratimin e mundshëm të masave të tjera që ndryshojnë karakteristikat e veglave të peshkimit, si dhe çdo ndikim tjetër të mundshëm në aktivitetet e peshkimit;

duke rikujtuar rekomandimin GFCM/36/2012/2, për zvogëlimin e zënieve të rastësishme të cetaceve në zonën e zbatimit të GFCM-së;

duke rikujtuar rekomandimin GFCM/37/2013/2, për vendosjen e disa standardeve minimale, për peshkimin me njica fundore për rombin dhe ruajtjen e cetaceve në Detin e Zi;

duke rikujtuar rekomandimin GFCM/43/2019/2, për përmirësimin e ruajtjes së cetaceve në zonën e zbatimit të GFCM-së (masat e ruajtjes, grumbullimin e të dhënave, këshillimin dhe vlerësimin shkencor);

duke marrë parasysh këshillën e Grupit të Punës për Teknologjinë e Peshkimit 2021 nga SAC-i dhe, në veçanti, nevojën për të rritur selektivitetin e veglave të peshkimit për të zvogëluar zëniet e rastësishme dhe për të siguruar një status më të mirë ruajtjeje të cetaceve;

miraton, në përputhje me nenet 5/b, 8/b dhe 13, të Marrëveshjes GFCM, rekomandimin e mëposhtëm:

PJESA I OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM

1. Palët kontraktuese dhe palët jokontraktuese bashkëpunuese (CPC) duhet të nxisin masat e mëtejshme për të përmirësuar statusin e ruajtjes së specieve të cetaceve dhe për të ndërmarrë përpjekje në mbështetje të veprimeve globale ose rajonale, për investigimin e masave të duhura, për zvogëlimin e zënieve rastësore dhe implementimin e tyre sipas nevojës, në bashkëpunim me komunitetet e peshkatarëve dhe palët e tjera të interesuara.

2. CPC-të duhet të përmirësojnë grumbullimin e të dhënave dhe monitorimin duke raportuar informacionin mbi nivelet e zënieve rastësore të cetaceve në përputhje me manualin teknik “*Monitorimi i zënieve aksidentale të specieve të rrezikuara nga peshkimi në Detin Mesdhe dhe Detin e Zi: metodologjia për grumbullimin e të dhënave*” dhe sipas DCFR-së, me synim mbështetjen e programeve rajonale të monitorimit.

PJESA II RUAJTJA DHE MASAT MENAXHUESE

3. CPC-të ftohen të zgjerojnë masat lidhur me zëniet aksidentale për të zvogëluar dhe eliminuar, brenda mundësive, zëniet aksidentale të cetaceve gjatë aktivitetit të peshkimit për format e peshkimit me rrezik të lartë të përcaktuar nga SAC-i, shoqëruar nga një proces monitorimi për vendosjen e efikasitetit të këtyre masave. Këto masa lehtësuese mund të përfshijnë, ndër të tjera:

- modifikimin e veglave të peshkimit dhe përdorimin e veglave alternative;
- përmirësimin e shënjitit dhe zbulueshmërisë së veglave të peshkimit;
- kufizimin ose mbylljen në hapësirë dhe në kohë, nëse është e përshtatshme;
- implementimin e limiteve maksimale të mundshme për zëniet rastësore;
- implementimin e pajisjeve të ndryshme akustike;
- modifikimin në strategjitë dhe sjelljen në peshkim.

4. CPC-të të identifikojnë zonat me risk të lartë, në lidhje me ndërveprimet midis peshkimit dhe cetaceve, bazuar në problemet ekzistuese dhe mund të vlerësojnë ndryshimet në legjislacionin kombëtar.

5. CPC-të mund të konsiderojnë, në bazë vullnetare, lloje të tjera të menaxhimit si “*menaxhimi mbi bazën e nxitjeve*”, i cili vlerëson operatorët me impakt të ulët dhe njëkohësisht duke drejtuar operatorët me performancë të ulët të ndërmarrin praktika më të mira ose të largohen nga aktiviteti i peshkimit; “*menaxhim bazuar në nxitjen e tregjeve*” duke përdorur etiketim për format e peshkimit me risk të mesëm dhe të lartë, si për shembull, “*dolphin-safe*” (ose “*dolphin-friendly*”).

6. CPC-të të lehtësojnë implementimin e masave për të shmangur ngatërrimet gjatë gjuetisë dhe duke reduktuar vdekshmërinë pas lëshimit me anë të manualeve¹ dhe trajnimeve.

7. CPC-të duhet të njoftojnë sekretariatit e GFCM-së, jo më vonë se 2026-ta, për të paktën dy masa lehtësuese të miratuara sipas neneve 3, 4, 5 dhe 6, për të përmirësuar statusin e ruajtjes së cetaceve, për të zvogëluar ose nëse është e mundur eliminuar rrezikun e zënieve të rastësishme të cetaceve gjatë aktivitetit të peshkimit dhe vdekshmërinë e tyre.

8. SAC-i mund të rekomandojë masa shtesë gjatë mbledhjes vjetore të GFCM-së (48-të).

PJESA III RISHIKIMI, PËRSHTATJA DHE MONITORIMI SHKENCOR

9. SAC-it dhe WGBS-së i kërkohet të formulojnë, vlerësojnë dhe përcaktojnë të gjitha të dhënat, informacionet dhe veprimet e disponueshme të raportuara sipas rekomandimit GFCM/36/2012/2 “*mbi zvogëlimin e zënieve të rastësishme të cetaceve në zonën e zbatimit të GFCM-së*”, sipas DCRF-së dhe çdo burimi tjetër informacioni shtesë, duke përfshirë, por pa u kufizuar, literaturën shkencore, fushatat kërkimore në det, projektet kërkimore etj.

10. Me kërkesë të CPC-ve, me ndihmën e sekretariatit të GFCM-së, GFCM-ja do të krijojë, në vitin 2023, një projekt pilot me synim krijimin e një programi vëzhgimi dhe monitorimi për të mbledhur të dhëna shtesë dhe për të siguruar përpunimin me masat e ruajtjes dhe menaxhimit të përfshira në këtë rekomandim.

11. Sesioni i njëzet e gjashtë (26-të) i SAC-it në 2025-n dhe sesioni i trembëdhjetë (13-të) i WGBS-së do t'i raportojnë GFCM-së mbi progresin e arritur, boshllëqet e identifikuar në njohuri, duke përfshirë studimet socio-ekonomike mbi dëmin e shkaktuar nga cetacet, me qëllim që të përpunohen masat e duhura për zvogëlimin dhe kompensimin e zënieve rastësore, të cilat mund të ndihmojnë në parandalimin e reagimeve të peshkatarëve. Ato do të sigurojnë elementet e nevojshme për përcaktimin e një kornize menaxhimi për zëniet rastësore që do të përfshijë gjithashtu reflektime mbi qëllimet dhe objektivat e ruajtjes, afatin kohor në të cilin këto qëllime dhe objektiva duhet të përmbushen, nivelet maksimale të mundshme për zëniet rastësore, mbulimin e dedikuar të vëzhguesve shkencor në bord dhe, nëse është e mundur, vlerësimet më të mira të madhësisë së këtyre popullatave. Bazuar në të dhënat e mbledhura, SAC-i do të përshtatë dhe plotësojë, nëse është e nevojshme, bazuar në aktivitetin e peshkimit, masat e renditura në pjesën II të këtij rekomandimi për të zvogëluar, ulur dhe kur është e mundur, eliminuar zëniet e rastësishme me udhëzime dhe trajnime² të përshtatshme.

12. Këshillat e SAC-it dhe WGBS-së në 2025-n duhet të lehtësojnë përpjekjet e ruajtjes, të bazuara në zona dhe kërcënime³ për të kontribuar në menaxhimin e ruajtjes së cetaceve.

¹ Shih: *Accobams/GFCM/FAO Good practice guide for the handling of cetaceans caught incidentally in fisheries* <http://www.fao.org/gfcm/publications/projectsandinitiatives/en/>.

² Shih: *Accobams/GFCM/FAO Good practice guide for the handling of cetaceans caught incidentally in fisheries* <http://www.fao.org/gfcm/publications/projectsandinitiatives/en/>.

³ ACCOBAMS *threats-based management approach based on pressures such as: Interactions with fisheries (all), Pollution including marine litter, Anthropogenic noise, Ship strikes, Cetacean watching, Captivity related issues, Climate change impacts, others.*

13. Në sesionin e tij të dyzet e tetë (48-të) në 2025-n, pas marrjes së këshillës nga SAC-i dhe WGBS-ja, GFCM-ja do të marrë në konsideratë, nëse është e përshtatshme, miratimin e masave të mëtejshme që lejojnë arritjen e objektivave të këtij rekomandimi.

PJESA IV DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

14. Dispozitat e këtij rekomandimi nuk paragjykojnë masat shtesë ose më të rrepta të miratuara ose që mund të miratohen nga CPC-të.

REKOMANDIMI GFCM/44/2021/16 **MBI MASAT SHITESË LEHTËSUESE PËR RUAJTJEN E ELASMOBRANKËVE NË** **DETIN MESDHE**

Komisioni i Përgjithshëm i Peshkimit për Mesdheun (GFCM),

duke rikujtuar se objektivi i Marrëveshjes për krijimin e Komisionit të Përgjithshëm të Peshkimit për Mesdheun (Marrëveshja GFCM) është të sigurojë ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm, në nivel biologjik, social, ekonomik dhe mjedisor, të burimeve të gjalla detare në zonën e zbatimit të GFCM-së;

duke rikujtuar se Deklarata Ministeriale e Maltës MedFish4Ever, e vitit 2017 (në tekstin e më poshtëm “Deklarata MedFish4Ever”) kërkon, në kuadrin e hartimit të një plani menaxhimi për peshkimin të bazuar në ekosistem, duke siguruar mbrojtjen e duhur për speciet e rrezikuara dhe habitatet e ndjeshme;

përshtatja e parimeve të Kodit të Sjelljes për Peshkimin e Përgjegjshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Ushqimin dhe Bujqësinë (FAO) dhe duke kujtuar qasjen e kujdesshme të ekosistemit ndaj menaxhimit të peshkimit;

duke njohur se peshkimi dhe zëniet e rastësishme nga aktiviteti i peshkimit ka të ngjarë të jetë kërcënim më serioz aktual antropogjen për peshkaqenët, rajat dhe të gjitha speciet e tjera (për speciet elasmobrankë);

duke rikujtuar Planin Ndërkombëtar të Veprimit të FAO-s për Ruajtjen dhe Menaxhimin e Peshkaqenëve (IPOA-SHARKS);

duke rikujtuar Konventën për Mbrojtjen e Mjedisit Detar dhe Rajonit Bregdetar të Mesdheut (Konventa e Barcelonës) dhe renditjen e disa llojeve të peshkaqenëve në aneksin II ose shtojcën III, të protokollit të tij lidhur me Zonat e Mbrojtura Veçanërisht dhe Diversitetin Biologjik në Mesdhe (SPA /protokolli BD);

duke marrë parasysh rëndësinë e harmonizimit të masave të ruajtjes dhe menaxhimit me konventat e tjera ndërkombëtare për mbrojtjen e specieve elasmobrankë;

duke paraqitur këshillën e Komitetit Këshillimor Shkencor për Peshkimin (SAC) dhe, në veçanti, nevojën për identifikimin e specieve dhe sigurimin e një statusi më të mirë ruajtjeje të elasmobrankëve, duke përfshirë mbrojtjen e zonave bregdetare nga mjetet më aktive të peshkimit;

duke marrë parasysh Listën e Kuqe për Llojet e Kërcënuara të Bashkimit Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës (IUCN) dhe vlerësimin e statusit për Mesdheun, për speciet e përzgjedhura të elasmobrankëve që aktualisht janë të përfshira në aneksin III të protokollit SPA/BD;

duke rikujtuar rekomandimet nga Rishikimi i Dytë i Performancës së GFCM-së që kërkojnë zhvillimin e masave të ruajtjes dhe planit të menaxhimit, duke përdorur plotësisht ndërlidhjen shkencë-politikë të ofruar nga Komiteti Këshillimor Shkencor (SAC); GFCM-ja duhet të ndërmarrë masat e duhura të menaxhimit të përkohshëm (brenda 5 viteve) për të ruajtur peshkimin, rezervat dhe habitatet e prekura nga peshkimi duke përfshirë peshkimin artizanal;

duke marrë parasysh miratimin e një strategjie të re të GFCM-së (2021–2030) drejt peshkimit të qëndrueshëm në Detin Mesdhe dhe Detin e Zi që përfshin një objektiv specifik për minimizimin dhe uljen e ndërveprimeve të padëshiruara midis peshkimit, ekosistemeve detare dhe mjedisit;

duke paraqitur rekomandimin GFCM/42/2018/2 që ndalon prerjen e pendëve të peshkaqenëve dhe kërkon marrjen e masave për ruajtjen e tyre, si dhe kërkon që pendët të jenë të ngjitura në mënyre natyrale për të gjithë peshkaqenët e zbarkuar;

duke marrë parasysh rekomandimet ICCAT/04-10, ICCAT/07-06 dhe WCPFC CMM/2010-07 që kërkojnë lirim të sigurt për të gjitha llojet e peshkaqenëve të zënë, zbatimin e masave të lidhura me tregtinë, si dhe masat për selektivitetin e mjeteve të peshkimit, dimensionet minimale dhe mbylljet në kohë dhe hapësirë;

duke marrë parasysh se sinergjitë për çështjet me interes reciprok do të kërkojnë ndërmjet ICCAT-it, GFCM-së dhe organizatave rajonale të menaxhimit të peshkimit;

duke paraqitur këshillat e Grupit të Punës 2021, për Teknologjinë e Peshkimit nga SAC-i dhe, në veçanti, nevojën për të rritur selektivitetin e veglave të peshkimit për të reduktuar zëniet e rastësishme dhe për të siguruar një status më të mirë ruajtjeje të varieteteve të peshkaqenëve;

miraton, në përputhje me nenet 5/b, 8/b dhe 13, të Marrëveshjes GFCM, rekomandimin e mëposhtëm:

PJESA I OBJEKTIVI I PËRGJITHSHËM, QËLLIMI DHE PËRKUFIZIMET

Objektivi i përgjithshëm

1. Palët kontraktuese dhe palët jokontraktuese bashkëpunuese (CPC) do të nxisin veprime të mëtejshme në zonën e zbatimit të GFCM-së për të përmirësuar statusin e ruajtjes së peshkaqenëve dhe rajave (dhe të tjerë elasmobrankëve), duke marrë masa për të ulur ose eliminuar, aty ku është e mundur, rrezikun për zëniet e rastësishme nga aktiviteti i peshkimit dhe/ose vdekshmërinë lidhur me peshkimin.

Fushëveprimi

2. Ky rekomandim zbatohet për të gjitha speciet elasmobrankë në Detin Mesdhe të listuara në aneksin II dhe III, të protokollit SPA/BD dhe përfshin miratimin e veprimeve specifike për speciet siç renditen në aneksin 1 të këtij rekomandimi.

Përkufizimet

3. Për qëllime të këtij rekomandimi, do të zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

a) “aktivitet peshkimi çlodhës” do të thotë peshkim jotregtar që shfrytëzon burimet biologjike detare për argëtim, turizëm ose sport. Aktivitete të tilla mund të ushtrohen nga persona fizik ose juridik, duke përfshirë edhe subjekte tregtare në sektorët e turizmit dhe konkurseve sportive;

b) “Peshkimi i paligjshëm, i paraportuar dhe i parregulluar ose peshkimi PPP” nënkupton aktivitetet e përshkruara në paragrafin 3, të Planit Ndërkombëtar të Veprimit të FAO-s, në vitin 2001, për parandalimin, pengimin dhe eliminimin e peshkimit të paligjshëm, të paraportuar dhe të parregulluar (IPOA-IUU) dhe në vijim dispozitat e rekomandimit GFCM/41/2017/7;

c) “Anije që peshkon në mënyrë aktive” nënkupton çdo anije që angazhohet në aktivitet peshkimi dhe ka të drejtën nga CPC-të flamur, të kryejë aktivitete të veçanta peshkimi gjatë një periudhe të caktuar, në një zonë të caktuar ose për një peshkim të caktuar, në kushte specifike;

ç) “Manuali i DCRF-së” nënkupton manualin e përgatitur nga SAC-i dhe i miratuar nga Komisioni i GFCM-së në sesionin e tij të 47-të, që rezulton nga zbatimi i Kornizës Referuese për Grumbullimin e të Dhënave (DCRF).

PJESA II

MASAT E MENAXHIMIT

4. CPC-të ftohen të ndërmarrin hapat e nevojshëm për të reduktuar vdekshmërinë për specie të elasmobrankëve të zënë rastësisht gjatë aktivitetit të peshkimit, duke miratuar masat përkatëse lehtësuese, duke përfshirë krijimin e një sistemi që ofron stimuj për kapitenët e anijeve për të reduktuar vdekshmërinë nga zëniet e rastësishme të elasmobrankëve, si dhe një sistem trajnimesh teknike dhe certifikimin për kapitenët; dhe duke kryer kërkime për të përmirësuar veglat e peshkimit, pajisjet dhe teknikat e peshkimit për të reduktuar vdekshmërinë e elasmobrankëve nga zëniet e padëshiruara dhe për të rritur shkallën e mbijetesës pas lëshimit.¹

5. CPC-të ftohen të miratojnë masa lehtësuese për të zvogëluar dhe eliminuar, ku është e mundur, zëniet e rastësishme të elasmobrankëve gjatë aktivitetit të peshkimit me risk të lartë për zëniet e padëshiruara të përcaktuara nga SAC-i, dhe kur është e mundur në peshkimin me risk të ulët për zëniet e padëshiruara, shoqëruar nga monitorimi i duhur për të përcaktuar efikasitetin e veprimeve. Masa të tilla lehtësuese mund të përfshijnë, ndër të tjera:

- ndryshimet e veglave të peshkimit dhe llojet alternative të veglave;
- përmirësime në veglat e peshkimit për shënjimin dhe zbulimin;
- kufizime në hapësirë dhe në kohë ose mbyllje totale e aktivitetit të peshkimit, nëse është e përshtatshme;
- vendosja e limiteve maksimale për zëniet e padëshiruara;
- vendosja e pajisjeve frenuese magnetike, kur bazohet në studime shkencore dhe pas një vlerësimi kosto-përfitim.

6. CPC-të mund të konsiderojnë në bazë vullnetare lloje të tjera të menaxhimit si “menaxhimi mbi bazën e nxitjeve”, i cili vlerëson operatorët me impakt të ulët dhe njëkohësisht duke drejtuar operatorët me performancë të ulët të ndërmarrin praktika më të mira ose të largohen nga aktiviteti i peshkimit; “menaxhim bazuar në nxitjen e tregjeve” duke përdorur etiketim për format e peshkimit me risk të mesëm dhe të lartë, si për shembull, “*elasmobranch-safe*” (ose “*elasmobranch-friendly*”) në peshkimin me risk të mesëm dhe të lartë.

7. CPC-të do t’u kërkojnë anijeve të peshkimit, që zënë në mënyrë rastësore peshkaqenë, të kufizojnë zënien e padëshiruar të peshkaqenëve të listuar në aneksin III, të protokollit SPA/BD, në një përqindje maksimale të totalit në peshë të zënies për udhëtim peshkimi ose jo më shumë se tre individë. Në vitin 2023, SAC-i do të vlerësojë të dhënat më të përditësuara për zëniet dhe përbërjen në nivel speciesh. Bazuar në këshillat shkencore, sesioni i 46-të i GFCM-së do të vendosë një përqindje maksimale të kufirit të zënies, të shprehur në peshë.

PJESA III

MBLEDHJA, MONITORIMI DHE ANALIZIMI I TË DHËNAVE

8. CPC-të do të rrisin dhe përmirësojnë mbledhjen e të dhënave dhe informacionin e raportimit të monitorimit për zëniet e rastësishme të elasmobrankëve në përputhje me dispozitat e rekomandimit GFCM/42/2018/2, me manualin teknik të: “Monitorimi i zënieve rastësore të specieve të rrezikuara nga peshkimi në Mesdhe dhe në Detin e Zi: metodologjia për mbledhjen e të dhënave” dhe detyrën 3 të manualit të DCRF-së, që synon mbështetjen e programeve rajonale të monitorimit.

¹ Shih: Accobams/GFCM/FAO Good practice guide for the handling of sharks and rays caught incidentally in fisheries <http://www.fao.org/gfcm/publications/projectsandinitiatives/en/>.

9. CPC-të ftohen të identifikojnë habitatet kritike të elasmobrankëve, të studiojnë ndikimin e veglave të peshkimit (p.sh. linjat e grepave) dhe alternativat e tyre; duke u bazuar në ndikimet ekzistuese, ata mund të vlerësojnë ndryshimin e legjislacionit në fuqi kombëtar.

10. SAC-i ftohet, kudo që është e përshtatshme, të kryejë studime socio-ekonomike mbi dëmtimet e shkaktuara nga elasmobrankët, me qëllim që të përpunohen masat e duhura të kompensimit dhe zvogëlimit për zëniet e padëshiruara, të cilat mund të ndihmojnë në parandalimin e reagimeve të peshkatarëve.

11. Me kërkesë të CPC-ve, me ndihmën e sekretariatit të GFCM-së, GFCM-ja do të krijojë, në vitin 2022, projekte pilot për speciet e listuara në aneksin II dhe III, të protokollit SPA/BD të Konventës së Barcelonës, me synimin për të krijuar një program vëzhgimi dhe monitorimi, me qëllim mbledhjen e të dhënave shtesë dhe sigurimin e respektimit të masave për ruajtjen dhe menaxhimin, të përfshira në këtë rekomandim.

12. CPC-të do të raportojnë jo më vonë se 30 prill 2026 për të paktën një aktivitet, për specie/gjini nga shtojca 1 e pranishme në GSA, ku kryhen aktivitetet e peshkimit, ose të paktën pesë veprime specifike për speciet në total, për të përmirësuar statusin e ruajtjes së elasmobrankëve, zvogëlimin dhe ku është e mundur eliminimin e rrezikut të zënies rastësore të elasmobrankëve gjatë aktivitetit të peshkimit dhe vdekshmërinë nga peshkimi.

13. SAC-it, deri në vitin 2025, i kërkohet të formulojë, diskutojë dhe vlerësojë rezultatet e veprimeve të renditura në aneksin I, siç raportohet nga CPC-të, duke përfshirë të dhënat e disponueshme për shpërndarjen hapësinore të habitateve kritike të elasmobrankëve. Sekretariati i GFCM-së do të implementojë një instrument të raportimit *ad-hoc* për të lehtësuar transmetimin e të dhënave të kërkuara përmes platformave aktuale si: GFCM, DCRF dhe/ose Raportet Kombëtare për SAC-in.

14. Bazuar në rezultatet, SAC-i do të këshillojë në lidhje me përcaktimin e masave të reja, me qëllim përmirësimin e statusit të elasmobrankëve të renditura në aneksin II dhe III, të protokollit SPA/BD në Mesdhe dhe Detin e Zi, si p.sh., por jo duke u kufizuar në:

a) përcaktimin e maksimumit të % (në peshë) ose jo më shumë se tre individ për anije, të totalit të zënies të padëshiruara për specie e listuara në aneksin III, të protokollit SPA/BD, për udhëtim peshkimi;

b) miratimin e një madhësie minimale dhe maksimale specifike për speciet që do të zihen e cila merr parasysh periudhën e riprodhimit dhe mënyrën riprodhuese të specieve të listuara në aneksin III dhe që nuk mbulohen nga shkronja ç;

c) kufizimin e peshkimit çlodhës-argëtues për elasmobrankë;

ç) kufizimin e zënies, zbarkimit dhe shitjes së specieve të rregulluara nga ky rekomandim.

15. SAC-i do të këshillojë gjithashtu, deri në vitin 2025, për specie të tjera të rrezikuara ose kritike të elasmobrankëve në Detin Mesdhe dhe do të sigurojë një përditësim të aneksit I të këtij rekomandimi.

16. SAC-i do të këshillojë gjithashtu, deri në vitin 2023, në lidhje me praktikën e mira për të rritur shkallën e mbijetesës pas lirimit të elasmobrankëve pjesë e zënieve të padëshiruara nga forma peshkimi të ndryshme nga linja grepash pelagjikë, për të cilat është miratuar një udhëzues midis CPC-ve¹.

17. Sesioni i njëzet e katërt (24-të) i SAC-i në 2023-shin do t'i raportojë GFCM-së mbi progresin e arritur, mangësitë e identifikuar në njohuri dhe do të sigurojë elementet e nevojshme për krijimin e një kornize për ruajtjen dhe menaxhimin për speciet e listuara në aneksin II dhe III, të protokollit SPA/BD, që do të përfshijë gjithashtu reflektime mbi qëllimet dhe objektivat e ruajtjes, afatin kohor

¹ Shih: Accobams/GFCM/FAO Good practice guide for the handling of sharks and rays caught incidentally in fisheries <http://www.fao.org/gfcm/publications/projectsandinitiatives/en/>.

gjatë të cilit duhet të përmbushen këto qëllime dhe objektiva, një limit vjetor potencial maksimal të vdekshmërisë “*elasmobranch-limit*” (EML), mbulimin e dedikuar të vëzhguesve shkencor në bord dhe, nëse është e mundur, vlerësimet më të mira të madhësisë së popullatës.

PJESA V DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

18. CPC-të do të tërheqin vëmendjen e autoriteteve përkatëse kombëtare dhe ndërkombëtare për të mbrojtur speciet elasmobrankë nga ndikimi i aktivitetit të peshkimit që rrezikojnë ruajtjen e këtyre specieve të veçanta.

19. Ky rekomandim nuk do të paragjykojë miratimin e masave më të rrepta nga CPC¹-të.

20. Këshillat e SAC-it në 2023-shin duhet të lehtësojnë përpjekjet për ruajtjen e zonës dhe kërcënimeve për të kontribuar në menaxhimin e ruajtjes së specieve elasmobrankë.

21. SAC-i do të shqyrtojë këtë rekomandim në vitin 2024 dhe Komiteti i Pajtuësshmërisë (CoC) do të shqyrtojë zbatimin e tij në baza dyvjeçare.

22. Në sesionin e tij të dyzetegjashtë (46-të) në 2023-shin, pas marrjes së kësaj nga SAC-i dhe CoC-ja, GFCM-ja do të shqyrtojë, nëse është e përshtatshme, miratimin e masave të mëtejshme që lejojnë arritjen e objektivave të këtij rekomandimi.

SHTOJCA I

Veprimet specifike për speciet:

- Peshkaqen pëllumb (*mustelus asterias*, *m. mustelus*, *m. punctulatus*):
 - vlerësimi i shkallës së zënieve të padëshiruara dhe të synuara nga të gjitha format e peshkimit, duke përfshirë tratat pelagjike/fundore që zënë pelagjikët e vegjël;
 - vlerësimi i shkallës së mbijetesës për individët e zënë në mënyrë të padëshiruar në forma të ndryshme peshkimi;
 - identifikimi i habitateve kritike;
 - identifikimi i teknologjive të peshkimit për të reduktuar zëniet e padëshiruara dhe për të rritur shkallën e mbijetesës pas lëshimit;
 - hartimi i masave menaxhuese të peshkimit (përfshirë kufizime në hapësirë) që mund të ndikojnë pozitivisht në ruajtjen e kësaj specije;
 - vlerësimi i kërkesës së tregjeve prioritare (vendas, eksport, etj.).
- Peshkaqeni dhëpër (*alopias vulpinus*):
 - vlerësimi i shkallës së zënieve të padëshiruara dhe të synuara nga të gjitha format e peshkimit, duke përfshirë tratat pelagjike/fundore që zënë pelagjikët e vegjël;
 - vlerësimi i shkallës së mbijetesës për individët e zënë në mënyrë të padëshiruar në forma të ndryshme peshkimi;
 - identifikimi i habitateve kritike;
 - identifikimi i teknologjive të peshkimit për të reduktuar zëniet e padëshiruara dhe për të rritur shkallën e mbijetesës pas lëshimit;
 - hartimi i masave menaxhuese të peshkimit (përfshirë kufizime në hapësirë) që mund të ndikojnë pozitivisht në ruajtjen e kësaj specije;
 - vlerësimi i kërkesës së tregjeve prioritare (vendas, eksport, etj.).

¹ Threats-based management approach is based on pressures such as: Interactions with fisheries (all), Pollution including marine litter, Anthropogenic noise, Ship strikes, At-sea watching, Captivity related issues, Climate change impacts, others. It has been for instance adopted in ACCOBAMS for cetaceans species.

- Peshkaqeni i hirtë (*carcharhinus plumbeus*):
 - vlerësimi i shkallës së zënieve të padëshiruara dhe të synuara nga të gjitha format e peshkimet, duke përfshirë tratat pelagjike/fundore që zënë pelagjikët e vegjël;
 - vlerësimi i shkallës së mbijetesës për individët e zënë në mënyrë të padëshiruar në forma të ndryshme peshkimi;
 - identifikimi i habitateve kritike;
 - identifikimi i teknologjive të peshkimit për të reduktuar zëniet e padëshiruara dhe për të rritur shkallën e mbijetesës pas lëshimit;
 - hartimi i masave menaxhuese të peshkimit (përfshirë kufizime në hapësirë) që mund të ndikojnë pozitivisht në ruajtjen e kësaj speciejë;
 - vlerësimi i kërkesës së tregjeve prioritare (vendas, eksport, etj.).
- Peshkaqeni kokërrzor/peshkaqeni gllabërues (*centrophorus granulosus*):
 - vlerësimi i shkallës së zënieve të padëshiruara dhe të synuara nga të gjitha format e peshkimet, duke përfshirë tratat pelagjike/fundore që zënë pelagjikët e vegjël;
 - vlerësimi i shkallës së mbijetesës për individët e zënë në mënyrë të padëshiruar në forma të ndryshme peshkimi;
 - identifikimi i habitateve kritike;
 - identifikimi i teknologjive të peshkimit për të reduktuar zëniet e padëshiruara dhe për të rritur shkallën e mbijetesës pas lëshimit;
 - hartimi i masave menaxhuese të peshkimit (përfshirë kufizime në hapësirë) që mund të ndikojnë pozitivisht në ruajtjen e kësaj speciejë;
 - vlerësimi i kërkesës së tregjeve prioritare (vendas, eksport, etj.).
- Peshkaqeni me dhëmbë (*hepstranchias perlo*):
 - vlerësimi i shkallës së zënieve të padëshiruara dhe të synuara nga të gjitha format e peshkimet, duke përfshirë tratat pelagjike/fundore që zënë pelagjikët e vegjël;
 - vlerësimi i shkallës së mbijetesës për individët e zënë në mënyrë të padëshiruar në forma të ndryshme peshkimi;
 - identifikimi i habitateve kritike;
 - identifikimi i teknologjive të peshkimit për të reduktuar zëniet e padëshiruara dhe për të rritur shkallën e mbijetesës pas lëshimit;
 - hartimi i masave menaxhuese të peshkimit (përfshirë kufizime në hapësirë) që mund të ndikojnë pozitivisht në ruajtjen e kësaj speciejë;
 - vlerësimi i kërkesës së tregjeve prioritare (vendas, eksport, etj.).
- Peshkaqeni gjembor (*squalus acanthias*):
 - vlerësimi i shkallës së zënieve të padëshiruara dhe të synuara nga të gjitha format e peshkimet, duke përfshirë tratat pelagjike/fundore që zënë pelagjikët e vegjël;
 - vlerësimi i shkallës së mbijetesës për individët e zënë në mënyrë të padëshiruar në forma të ndryshme peshkimi;
 - identifikimi i habitateve kritike;
 - identifikimi i teknologjive të peshkimit për të reduktuar zëniet e padëshiruara dhe për të rritur shkallën e mbijetesës pas lëshimit;
 - hartimi i masave menaxhuese të peshkimit (përfshirë kufizime në hapësirë) që mund të ndikojnë pozitivisht në ruajtjen e kësaj speciejë;
 - vlerësimi i kërkesës së tregjeve prioritare (vendas, eksport, etj.).
- Peshkaqeni jeshil (*prionace glauca*):
 - vlerësimi i shkallës së zënieve të padëshiruara dhe të synuara nga të gjitha format e peshkimet, duke përfshirë tratat pelagjike/fundore që zënë pelagjikët e vegjël;

- vlerësimi i shkallës së mbijetesës për individët të zënë në mënyrë të padëshiruar në forma të ndryshme peshkimi;
- identifikimi i habitateve kritike;
- identifikimi i teknologjive të peshkimit për të reduktuar zëniet e padëshiruara dhe për të rritur shkallën e mbijetesës pas lëshimit;
- hartimi i masave menaxhuese të peshkimit (përfshirë kufizime në hapësirë) që mund të ndikojnë pozitivisht në ruajtjen e kësaj specije;
- vlerësimi i kërkesës së tregjeve prioritare (vendas, eksport, etj.).